

VENDIM
Nr.18, datë 26.2.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU-ENERGY” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13, pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 8 pika 4 dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.2.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat “a”, “b” “c”, “d”, “f” dhe “g”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte *(në kontratën koncesionare përcaktohet se organi shtetëror i autorizuar merr përsipër të kryejë procedurën e shpronësimit sipas legjislacionit në fuqi, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm për shpronësim nga koncesionari).*

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gjerat “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Gizavesh”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta